



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 4/9 Prot.

Tiranë, më 15 . 07 .2026

V E N D I M

Nr. 193, Datë 15 . 07 . 2026

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi², mori në shqyrtim ankesën nr.06 Regj., datë 05.01.2026, të shtetases A. B kundër Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Tiranë, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Në parashtrimet e depozituara pranë Komisionerit, ankuesja pretendon diskriminim nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Tiranë, në cilësinë e institucionit përgjegjës për administrimin financiar dhe mbikëqyrjen e marrëdhënive të punës në institucionin arsimor ku është e punësuar.

Znj. B ka paraqitur pranë KMD-së dhe dy ankesa të tjera njëkohësisht, të cilat ndërlidhen drejtpërdrejtë me të njëjtën ngjarje dhe për të njëjtat shkaqe me këtë ankesë, kundër: Drejtores së shkollës “Dora d’ Istria”, znj. E. H dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore³.

Të tria ankesat lidhen me të njëjtën ngjarje, aksidentin në punë ndodhur me datë 11.04.2025, me të njëjtat fakte e rrethana, ku pretendohet nga ana e ankuses, se veprimet e mosveprimet e

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Inspektoratit.

institucioneve përkatëse kanë prodhuar trajtim të pabarabartë dhe viktimizues, pas ushtrimit të së drejtave ligjore.

Ankuesja pretendon se secili nga këto subjekte ka transferuar përgjegjësinë te tjetri, duke e lënë pa mbrojtje efektive dhe duke e trajtuar në mënyrë të pabarabartë për shkak të gjendjes shëndetësore, paaftësisë së përkohshme në punë, për shkak të aksidentit në punë dhe ushtrimit të të drejtave të saj ligjore.

Më datë 11.04.2025, ankuesja pësoi aksident në vendin e punës, dokumentuar me vendim të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, si dhe me raportet mjekësore (Frakturë të shpatullës -Eprikizë, lëshuar nga mjeku i Spitalit të Traumës Tiranë, raport për paaftësi të përkohshme në punë për 6 (gjashtë) javë. I pari i datës 11.04.2025, deri më datë 25.04.2025 (për 14 ditë) dhe i dyti, raporti i Komisionit Mjeko-Ligjor, i datës 25.04.2025-26.05.2025.

Ankuesja pretendon se raportet mjekësore nuk u aplikuan korrektësisht, pasi njëri nuk u aplikua fare dhe tjetri u aplikua gabim dhe përtej afateve kohore, në datën 19.05.2025.

Znj. B, shpjegon se pas aksidentit në punë të datës 11.04.2025, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) i është drejtuar drejtuar ZVA-së dhe Inspektoratit me shkresë zyrtare, ku evidentohet problematika e administrimit të raporteve mjekësore dhe pasojat financiare që rrjedhin nga mosrespektimi i procedurës ligjore për aksidentin në punë, si dhe dërgimi gabim numrit të llogarisë. ISSH, me shkresë zyrtare, njoftoi se procesverbali i aksidentit (që mban datën 30.04.2025) nuk mund të merrej në konsideratë për shkak të mospërputhjes së datave dhe shkeljes së afateve ligjore.

Pavarësisht kësaj shkrese dhe pavarësisht faktit që aksidenti ka ndodhur në vendin dhe në orarin e punës, ankuesja pretendon se ZVAP Tiranë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim efektiv për të korrigjuar pagesën e raporteve dhe për korrigjimin e pasojave financiare dhe administrative.

Znj. B pretendon se mosveprimi institucional dhe trajtimi selektiv ndodh për shkak të ushtrimit të të drejtave të saj ligjore, duke përfshirë:

- Ankesat administrative;
- Procedurën pranë KMD-së;
- Proceset gjyqësore ndaj institucioneve arsimore, për rrjedhojë sjellja e ZVA-së përbën viktimizim institucional.

Ankuesja citon se, sjellja diskriminuese konsiston në:

- Mosveprimin institucional ndaj një punonjëseje në gjendje paaftësie për punë;
- Trajtim të pabarabartë, krahasuar me raste të ngjashme, duke mos garantuar të njëjtin standard mbrojtjeje;
- Viktimizim për shkak të ushtrimit të të drejtave ligjore;
- Përforsim i pasojave të diskriminimit të nisur nga punëdhënësja dhe i lehtësuar nga Inspektorati i punës.

Ankuesja citon se mosveprimi i ZVAP-së: nuk është thjesht neglizhencë administrative, është veprim selektiv dhe ndëshkues, dhe se përbën diskriminim në formën e viktimizimit.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, korrigjimin e plotë të pasojave financiare të shkaktuara, rekomandimin për administrimin korrekt të raporteve mjekësore si aksident në punë, pagesën e plotë të raporteve, llogaritjen dhe pagesën e interesave për vonesat e pajustificuara; marrjen e masave efektive për dëmshpërblim të pasojave të diskriminimit, marrjen e masave administrative për mospërsëritjen e rasteve të ngjashme, monitorimin e zbatimit të rekomandimeve nga ZVAP dhe institucionet e lidhura.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankuesit për diskriminim.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës me nr. 4/2 prot., datë 14.01.2026, ka kërkuar nga ZVAP Tiranë, ISSH dhe DRSSH Tiranë, informacionin dhe dokumentacionin respektiv.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 319/1prot., datë 26.01.2026, në informacionin e dërguar KMD-së, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Tiranë argumenton se nuk ka kryer asnjë shkelje ligjore ose diskriminim në trajtimin e rastit të mësueses A. B.

ZVAP Tiranë sqaron ndër të tjera se:

Më datë 11.04.2025, mësuesja u rrëzua te shkallët e shkollës "Dora D'Istria" dhe stafi i shkollës dhe oficeri i sigurisë i dhanë ndihmën e parë dhe u ofruan të thërrisnin ambulancën, por vetë mësuesja refuzoi pasi njoftoi bashkëshortin për ta transportuar në spital.

Shkolla njoftoi zyrtarisht Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) më datë 14.04.2025 (jashtë orarit zyrtar të punës), pasi ishte njoftuar për raportin mjekësor nga ankuesja (ngarkuar në sistemin e-RM-së nga mjeku i familjes, po më datë 14.04.2025)

Fillimisht, për muajin prill 2025, mësueses iu mbajti 20% e pagës për 6 ditë raporti, pasi sistemi online nuk e kishte të regjistruar raportin si aksident në punë. Pasi ZVAP u njoh me raportin e inspektimit (më datë 30.04.2025) që konfirmonte aksidentin në punë, bëri menjëherë korrigjimin: diferenca e prillit iu kalua në pagën e majit dhe raportet e muajit maj u paguan në masën 100%.

Për raportet mjekësore që zgjasin më shumë se 14 ditë dhe mbulohen nga Sigurimet Shoqërore, ZVAP sqaron se nuk ka asnjë akses apo të drejtë përlllogaritjeje, pasi ato procedohen drejtpërdrejt nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore/ISSH.

ISSH ka kthyer përgjigje se nuk mund ta konsiderojë ngjarjen si aksident në punë për efekt pagese afatgjatë, sepse procesverbali i Inspektoratit mban datën 30.04.2025, që është jashtë afatit ligjor prej 3 ditësh nga ndodhja e ngjarjes.

- Nëpërmjet shkresës me nr. 1223/1 prot., datë 26.01.2026, ISSH, ka dërguar pranë KMD-së, informacionin e kërkuar, duke parashtruar se:

Veprimtaria e ISSH-së rregullohet nga ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili bazohet në parimin "Paguaj sot, që të përfitosh nesër". Sa i përket raporteve mjekësore, ligji dhe Kodi i Punës sanksionojnë qartë se të ardhurat për periudhën deri në 14 ditët e para të raportit janë detyrim i plotë i punëdhënësit. Mbrojtja nga sigurimet shoqërore fillon vetëm nga dita e 15-të e raportit mjekësor.

Në zbatim të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij, aksidenti në punë duhet të deklarohet dhe njoftohet menjëherë nga punëdhënësi. Për më tepër, që ngjarja të njihet si e tillë për efekt sigurimesh, Procesverbali Tip duhet të nënshkruhet nga punëdhënësi, Inspektorati i Punës (ISHPSHSH) dhe ISSH brenda afatit ligjor prej 3 ditësh nga ndodhja e ngjarjes.

Bazuar në legjislacionin respektiv, ISSH është i detyruar të administrojë çdo kërkesë për shërbime dhe përfitime vetëm nëpërmjet platformës digjitale e-Albania. Punëdhënësi ose përfituesi duhet të aplikojë në shërbimin specifik, duke ngarkuar formularët standardë dhe raportet mjekësore elektronike përkatëse (e-Raporte).

Referuar të dhënave të administruara në sistemet shtetërore të menaxhimit të përfitimeve (PCAMS) dhe kontributeve (CMIS), lidhur me rastin e znj. B, ISSH ka konstatuar rrethanat zyrtare si më poshtë:

Më datë 19.05.2025, institucioni punëdhënës (Drejtoria Arsimore) ka kryer një aplikim online me numër gjurmimi 10059-202519051303422047460007 (p. 7). Në këtë aplikim janë ngarkuar dy raporte mjekësore të lëshuara nga sistemet elektronike, ku diagnoza e përcaktuar ishte *“Frakturë e skapulës (shpatullës)”*.

Raporti i parë (Nr. Regj. 1777, datë 14.04.2025) është me afat 14-ditor (nga 11.04.2025 deri më 25.04.2025), i lëshuar si *“Raport për paaftësi në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi”*.

Raporti i dytë (Nr. Regj. 528, datë 29.04.2025) është me afat 30-ditor (nga 25.04.2025 deri më 25.05.2025), i lëshuar si *“Raport mjekësor për sëmundje që trajtohen nga komisioni (KML) dhe mbulohen nga Sigurimet Shoqërore”*.

Lidhur me përpunimin e pagesës dhe kthimin e transfertës nga Banka, citohet se, Sektori i Përfitimeve Afatshkurtra (PASH) pranë DRSSH Tiranë, më datë 27.05.2025, ka shqyrtuar praktikën dhe ka miratuar pagesën për periudhën 01.05.2025 deri më 25.05.2025, në vlerën totale prej 49,626.4 lekë. Periudha e muajit prill nuk u pagua nga ISSH sepse, sipas sistemit të kontributeve (CMIS), muaji prill ishte deklaruar nga punëdhënësi me pagë të plotë, gjë që sipas nenit 57, të Ligjit nr. 77/1993 ndalon përfitimin e dyfishtë.

Më datë 09.06.2025, banka Raiffeisen ka kthyer mbrapsht urdhër-transfertën për shkak të pasaktësisë së numrit të llogarisë bankare të dërguar nga subjekti. ISSH ka njoftuar menjëherë ZVAP-në në portalin e-Albania më datë 10.06.2025 për të bërë saktësimet.

Rezulton se më datë 03.02.2026 është realizuar një aplikim i ri online me numër gjurmimi 10059-202603021636536083840008. Pasi u fut në përpunim, DRSSH Tiranë bëri të mundur ridërgimin e transfertës së prapambetur pranë bankës Credins në numrin e ri të llogarisë R00000287099.

ISSH sqaron se vlera e mësipërme është paguar e bazuar mbi pikën 1, të nenit 22 të Ligjit nr. 7703/1993 (për sëmundje të përgjithshme) dhe jo si aksident në punë (i cili paguhet 100% sipas nenit 47), trajtim i cili ka ardhur si pasojë e dy shkeljeve procedurale nga punëdhënësi:

- Përfaqësuesi i shkollës u paraqit për tërheqjen e procesverbalit të aksidentit pranë zyrave tona më datë 12.05.2025 dhe e dorëzoi atë të plotësuar vetëm më datë 23.05.2025, duke tejkaluar plotësisht afatin ligjor prej 3 ditësh nga ngjarja (11.04.2025)

- Në platformën e-Albania, nuk është bërë aplikim specifik në shërbimin “*Të ardhura për paqftësi të përkohshme nga aksidenti në punë...*” dhe nuk janë paraqitur raporte mjekësore të tipit specifik për aksidente.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, thekson se ka përmbushur çdo detyrim ligjor që hyn në sferën e tij të kompetencës dhe se pagesa e prapambetur e raporteve mjekësore (të lëshuara si sëmundje e përgjithshme) tashmë është ekzekutuar me sukses në llogarinë e saktësuar të znj. B në shkurt 2026. Çdo pretendim i mëtejshëm lidhur me njohjen e plotë të aksidentit apo dështimin e procedurave fillestare mbetet përgjegjësi ekskluzive e subjektit punëdhënës (shkollës) dhe Inspektoratit që ka ndjekur hetimin.

- Nëpërmjet shkresave me nr. 1619/1 prot., datë 28.01.2026, dhe me nr. 1619/4 prot., datë 16.02.2026, DRSSH Tiranë, ka dërguar pranë KMD-së, informacion, i cili në thelb është i njëjtë me qëndrimin dhe parashrimet e dërguara nga ISSH⁴.
- Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 4/7 prot., datë 25.03.2026, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 15.04.2026, me praninë e: subjektit ankues, përfaqësuesve me autorizim të ZVAP Tiranë⁵, përfaqësuesve me autorizim të DRSSH Tiranë⁶ dhe përfaqësuesit të ISSH-së⁷.

Gjatë seancës, palët mbajtën në thelb të njëjtin qëndrim me atë të paraqitur më parë në komunikimet dhe parashtrimet e tyre zyrtare të administruara në dosjen e ankueses.

Nga ana e përfaqësuesve të ZVAP Tiranë u theksua fakti se, përsa i takon marrëdhënieve të punës me znj. B, punëdhënësi është Shkolla. ZVAP Tiranë nuk është punëdhënësi i ankueses dhe se pranë saj, nga ana e Shkollës përcillet listëprezenca mujore. ZVAP ekzekuton listëprezenca siç dërgohen nga shkollat. Juristja e ZVAP Tiranë, sqaron lidhur me aplikimin online të raporteve mjekësore, duke evidentuar se, depozitojnë të gjithë kategoritë e raporteve mjekësore tek klauzola e lejes së barrëlidjes. Kjo procedurë ndiqet për të gjithë punonjësit dhe jo vetëm në rastin e znj. B. Pas dërgimit të aplikimit të raportit mjekësor, ka telefonuar ankuesen për ta orientuar të drejtohet pranë bankës për korrigjimin e të dhënave, pasi kanë rezultuar të pasakta (të dhëna të cilat janë marrë në bordero). Në vijim, punonjësja e ZVAP Tiranë ka riaplikuar dhe pavarësisht se sistemi i e-Albania

⁴ Shih shkresën me nr. 1223/1 prot., datë 26.01.2026.

⁵ E. B dhe B. S, sipas Autorizimit nr. 4410 prot., datë 15.04.2026, të Drejtores së ZVAP Tiranë.

⁶ K. Xh dhe L. Ll, sipas Autorizimit datë 14.04.2026, të Drejtorit të DRSSH Tiranë.

⁷ J. A, sipas Autorizimit të Drejtorit të ISSH Tiranë.

ka pasur probleme, janë marrë masat përkatëse duke konkluduar me korrigjimin e të listëprezencës, duke realizuar pagesën në muajin prill 2025, së bashku me pagën.

Në përfundim të seancës, palët depozituan edhe parashtrime shtesë me shkrim, të cilat iu bashkëlidhën dosjes administrative.

Në vijim të procedurës administrative, pala ankuese depozitoi përsëri pranë Komisionerit argumentet dhe pretendimet e saj lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, si dhe dokumentacion shtesë në mbështetje të tyre, materiale të cilat u administruan në dosjen e çështjes.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me mësues të tjerë, në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

Lidhur me sa më sipër, ankuesja pretendon se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në situata të njëjta me mësues të tjerë, por nuk solli asnjë rast krahasimor. Nga ana tjetër, ZVAP Tiranë konfirmoi se praktika dhe procedura e ndjekur për ankuesen është e njëjtë për të gjithë punonjësit (përfshirë mësuesit) dhe se znj. B nuk është trajtuar në mënyrë të diferencuar lidhur me pagesën e raporteve mjekësore, sipas listëprezencës së përcjellë për ekzekutim nga ana e Shkollës.

Në kushtet kur mungon “krahasuesi”, Komisioneri vlerëson nëse veprimet e ZVAP Tiranë janë në përputhje me standardet e dispozitat përkatëse ligjore.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, si dhe në analizë të legjislacionit poshtëcituar, Komisioneri vlerëson se:

Ankuesja pas aksidentit të pësuar në Shkollë më datë 11.04.2025, ka marrë raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë për periudhat: 11.04.2025 -25.04.2025 dhe 25.04.2025-25.05.2025.

Komisioneri vëren se, pagesa për periudhën e parë të raportit deri në 14 ditë, ekzekutohet bazuar në listëprezencën e aktet e përcjella ZVAP-së, nga punëdhënësi/Shkolla, ndërsa pagesa për periudhën e dytë të raportit mbi 14 ditë (30 ditë konkretisht) kryhet nga ISSH, e për rrjedhojë, Komisioneri nuk do të shprehet për këtë moment, pasi nuk është kompetencë e ZVAP-së, kundrejt të cilës është drejtuar ankesa.

Në kontekst të legjitimitetit pasiv të ZVAP Tiranë, si subjekt kundër të cilit ankuesja ngre pretendimin për diskriminim lidhur me mospagesën 100%, sa i takon periudhës që ajo ka qenë me

raport mjekësor, për shkak të aksidentit në punë më datë 11.04.2025, do të shqyrtojë këtë pretendim vetëm lidhur me periudhën 11.04.2025 deri më datë 25.04.2025.

Referuar raportit mjekësor, me nr. regj. 1777, datë 14.04.2025, të Qendrës Shëndetësore nr. 1, Tiranë, gjeneruar në e-RM, si “Raport për paaftësi në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi”, ankueses i jepet pushim për 14 ditë dhe i këshillohet regjim shtrati, për shkak të diagnozës “Frakturë e skapulës (shpatullës)”.

Bazuar në faktet e administruara gjatë hetimit administrativ, dokumentacionin e paraqitur nga palët dhe kuadrin ligjor në fuqi, Komisioneri vlerëson se analiza e rastit është fokusuar në përcaktimin nëse veprimet dhe mosveprimet e pretenduara të ZVAP Tiranë përbëjnë trajtim diskriminues, viktimizim apo trajtim më pak të favorshëm ndaj ankueses për shkak të gjendjes së saj shëndetësore ose për çdo shkak tjetër të mbrojtur nga LMD.

Sipas nenit 3/17⁸, të LMD-së, që një veprim ose mosveprim të konsiderohet "viktimizim", duhet të provohet ekzistenca e një lidhjeje shkakësore të drejtpërdrejtë midis ankesave të punonjësit dhe një mase ndëshkuese apo trajtimi të pafavorshëm me dashje nga institucioni, në këtë rast ZVAP-së.

Nga shqyrtimi i rastit rezultoi se vonesat administrative lidhur me pagesat e ankueses, nuk u motivuan apo nxitën nga një qëllim penalizues apo selektiv i ZVAP-së. Mosmarrëveshjet dhe vonesat në skemën e pagesës ishin pasojë e ngatërresave teknike të sistemit e-Albania dhe mosrakordimit të afateve kohore mes shkollës (si entitet juridik më vete), Inspektoratit të Punës dhe ISSH-së. Rrjedhimisht, nuk provohet elementi i dashjes apo i trajtimit selektiv.

Nga verifikimi i borderove dhe listëprezencave të muajve Prill–Maj 2025, provohet se ZVAP Tiranë e ka kryer pagesën e plotë të raportit 14-ditor që i takonte punëdhënësit. Fillimisht u aplikua ndalesa prej 20% pasi raporti në sistemin online ishte gjeneruar si “sëmundje e përgjithshme” (pa kod aksidenti). Pasi ZVAP-së i është komunikuar vendimi i Inspektoratit (më datë 30.04.2025), ZVAP bëri ndryshimin, duke e pasqyruar pagesën sipas udhëzimit të ISSH-së, si raport paaftësie për sëmundje të përgjithshme, duke paguar diferencën 100% për ditët që i takonin si institucion që ekzekuton listë pagesat e dërguara nga ana e punëdhënësit.

ZVAP nuk mund të ngarkojë në sistem një raport për “Aksident në Punë” nëse mjeku i familjes apo Komisioni Mjeko-Ligjor e ka gjeneruar atë si “Sëmundje e Përgjithshme”.

Shkresa e ISSH-së vërteton se të dyja raportet e mësueses u lëshuan në formatin: “*Raport për Paaftësi për Sëmundje të Përgjithshme*” (nga Qendra Shëndetësore Nr.1)

⁸ “*Viktimizimi*” është trajtim i disfavorshëm ose pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi, që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 1 të këtij ligji, lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit.

Sistemet e financës shtetërore janë të automatizuara dhe të lidhura me kodet e diagnozave të Ministrisë së Shëndetësisë. Financa e ZVAP-së nuk ka asnjë kompetencë ligjore apo mundësi teknike të ndryshojë kodin e një raporti mjekësor nga “sëmundje” në “aksident”.

Mosekzekutimi i pagesës në vlerën 100% për znj. B, ishte si rezultat i mosdeklarimit në afat i ngjarjes së datës 11.04.2025, si aksident në punë nga ana e punëdhënësit/Shkollës, pranë ISSH dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, e për pasojë ISSH e ka trajtuar përfitimin si “paaftësi e përkohshme për sëmundje të përgjithshme” dhe jo si aksident në punë.

Sa i takon pretendimit të ankueses se ZVAP duhet të ndërhynte për të ekzekutuar pagesat e raporteve që mbulohen nga Sigurimet Shoqërore, Komisioneri vëren se, sipas ligjit kontributiv, raportet që zgjasin përtej ditës së 15-të llogariten, miratohen dhe paguhen ekskluzivisht nga buxheti i ISSH-së. ZVAP Tiranë nuk ka asnjë qasje ligjore apo financiare mbi këto fonde. Fakti që pagesa prej 49,626.4 lekë u bllokua, erdhi për shkak të parregullsive në formatin e lëshuar të raporteve elektronike dhe vonës në dorëzimin e procesverbalit tip nga Inspektorati Shtetëror i Punës (i cili u dorëzua i plotësuar në ISSH më datë 23.05.2025). ZVAP nuk mund të konsiderohet përgjegjëse për refuzimet apo procedurat e kryera nga një institucion tjetër.

Komisioneri vëren se, ZVAP Tiranë administron borderotë për mijëra mësues, të cilat përpilohen mbi baza të dhënash të standardizuara. Nuk ka asnjë element specifik që të tregojë trajtim selektiv ndaj znj. B. Institucioni thjesht ka zbatuar udhëzimin e ISSH-së, i cili i komunikoi zyrtarisht se ngjarja nuk mund të konsiderohej aksident në punë për shkak të shkeljes së afatit 3-ditor nga ana e shkollës. ZVAP si institucion buxhetor, ka detyrimin të zbatojë vendimet e ISSH-së dhe nuk mund të paguajë fonde publike nëse ISSH i konsideron ato të pabazuara në ligj.

Komisioneri vëren se, sa i përket problematikës së numrit të llogarisë bankare, DRSSH Tiranë ka konfirmuar se përmes aplikimit online të datës 03.02.2026, Sektori PASH ka bërë ridërgimin e transfertës financiare në llogarinë e saktë të ankueses (pranë bankës Credins). Ky veprim tregon se sapo u sqaruan gabimet teknike të sistemit bankar, institucioni kreu rregullimet pa pasur nevojë për masa shtrënguese, gjë që rrëzon pretendimin e ankueses për "ndëshkim të qëllimshëm".

Pasi banka ktheu transfertën në qershor 2025, ISSH njoftoi në sistem lidhur me këtë fakt. ZVAP nuk mund të ndryshojë *kryesisht* numrin e llogarisë bankare të një punonjësi pa u depozituar zyrtarisht dokumenti i ri nga ana e tij (për arsye të sigurisë dhe auditimit financiar).

Siç konfirmon DRSSH Tiranë në shkresën e saj, “*për znj. A. B nuk ka më asnjë aplikim online të bërë nga subjekti*” deri në shkurt 2026. Vonesa 8-mujore erdhi sepse ankuesja refuzoi të riaplikonte saktë në e-Albania dhe të paraqiste IBAN-in e ri zyrtar pranë bankës. ZVAP veproi menjëherë më 03.02.2026, sapo u bë aplikimi i saktë në sistem. Rrjedhimisht, nuk ka pasur “heshtje të qëllimshme”, por pamundësi teknike dhe procedurale për të vepruar në mungesë të aplikimit nga ana e mësueses.

Që një sjellje të klasifikohet si diskriminuese ose viktimizuese, duhet të ekzistojë një lidhje e drejtpërdrejtë shkakësore midis vullnetit të institucionit dhe pasojës negative të ardhur.

Ankuesja pretendon se dërgimi i numrit të gabuar të llogarisë bankare dhe aplikimi i gabuar në e-Albania (nën kategorinë “shpërblim lindje”) përbëjnë diskriminim selektiv

Komisioneri vëren se, sistemi i e-Albania dhe menaxhimi i borderove bazohen në veprime teknike sekretariati. Regjistrimi i gabuar i një kodi apo numri llogarie përbën një "gabim teknik administrativ" (lapsus) dhe jo detyrimisht një sjellje të nxitur nga paragjykimi apo vullneti për të viktimizuar mësuesen për shkak të gjendjes së saj shëndetësore.

Në këtë aplikim ka dy momente: aplikimi në e-Albania në kodin e gabuar (“shpërblim lindje”) më 19.05.2025 dhe dërgimi i një numri të pasaktë llogarie bankare që u kthye nga banka Raiffeisen më 09.06.2025.

Komisioneri vëren se, gabimet materiale, teknike apo njerëzore gjatë hedhjes së të dhënave në sistemet informatike, të cilat prekin rëndom çdo punonjës pa dallim, nuk përbëjnë apriori diskriminim. Që veprimi të jetë diskriminues, duhet të vërtetohet se ZVAP i dërgon rregullisht saktë llogaritë e të gjithëve, por qëllimisht deformon vetëm llogarinë e znj. B për shkak të gjendjes shëndetësore të saj. Për më tepër, sapo DRSSH dhe ZVAP koordinuan të dhënat, transferata u korrigjua dhe u ekzekutua plotësisht më datë 05.02.2026 pranë bankës Credins (numri i llogarisë R00000287099), gjë që dëshmon mungesë të vullnetit për ta lënë mësuesen pa mbrojtje.

Komisioneri vlerëson se, ZVAP Tiranë ka treguar vullnet pozitiv për zhdëmtimin e mësueses (rregullimin e situatës) brenda hapësirës që i lejonte ligji, kjo pasi, sapo ZVAP mori raportin e parë të inspektimit, bëri përlllogaritjen e diferencës së pagës së muajit prill 2025 (ku ishte mbajtur 20%-shi) dhe ia kaloi mësueses në pagën e muajit maj 2025.

Për pjesën e raporteve që mbulohen nga skema e Sigurimeve Shoqërore (pas ditës së 14-të), ZVAP nuk ka autoritet ligjor llogaritjeje apo transferimi fondesh, pasi pagesa ekzekutohet drejtpërdrejt nga ISSH.

Nuk ka asnjë element të parashikuar nga neni 3, i Ligjit nr. 10221/2010, që ta fajësojë ZVAP-në për diskriminim. ZVAP nuk e ka trajtuar mësuesen ndryshe nga të tjerët; ajo thjesht ka zbatuar procedurën standarde për një dosje të cilës shkolla i kishte djegur afatet ligjore të njohjes si aksident në punë.

Për të pasur një konstatim të diskriminimit apo viktimizimit, në bazë të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, duhet të vërtetohet ekzistenca kumulative e tre elementeve: sjellja e pafavorshme/diferencuese, shkak i mbrojtur (gjendja shëndetësore/ankesat) dhe lidhja shkakësore midis tyre.

Ankuesja pretendon se ZVAP Tiranë ka ndërprerë pagesat dhe ka zvarritur procedurat si masë ndëshkimore (viktimizim) për shkak të ankesave dhe proceseve gjyqësore të hapura prej saj.

Nga shqyrtimi i provave dhe fakteve, rezultoi se asnjë nga këto elemente nuk plotësohet në ngarkim të ZVAP Tiranë, për arsyet si vijon:

Shkresa e Inspektoratit (nr. 4183/3 Prot, datë 23.09.2025) dhe ajo e DRSSH Tiranë provojnë se mosprocedimi i raporteve si “aksident në punë” nga zyra e financës së ZVAP-së nuk ka qenë një veprim selektiv apo penalizues.

Ai ka qenë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e shkresës nr. 12859/1 të ISSH-së, e cila ndryshoi masën e pagesës për znj. B, duke mos e klasifikuar si aksident në punë për shkak të kalimit të afateve nga ana e Shkollës.

Komisioneri vlerëson se, ZVAP Tiranë nuk mund të operonte mbi një skemë financiare (100% pagesë si aksident), në kushtet kur organi kompetent përkatës (ISSH) e kishte shpallur të paligjshme për atë rast.

Rrjedhimisht, mosveprimi i ZVAP-së është i diktuar nga ligji dhe jo i nxitur nga qëllimi për t'u hakmarrë ndaj mësueses. Në këto kushte, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese kundrejt ankueses, ardhur për shkaqet e pretenduara prej saj.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e ZVAP Tiranë, përse i takon veprimeve të kryera kundrejt ankueses.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, znj. A. B, lidhur me trajtimin e pagesave të raporteve mjekësore, nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)